

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:





PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

MUNDËSIA E SHQIPËRISË

në Turizmin e Qëndrueshëm:

Turizmi në rritje që sjell ndikime pozitive
për mjedisin, komunitetet lokale, kulturën,
vendet e punës dhe jetesën

Autor: Gavin Anderson



Ky dokument është prodhuar nga RisiAlbania. Risi është një projekt punësimi për të rinjtë i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, i zbatuar nga Helvetas dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Pikëpamjet dhe konkluzionet e përfshira këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane dhe as të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

PROJEKT STRATEGJIA KOMBËTARE E TURIZMIT 2024-2030 (TETOR 2024)*

“Gjatë viteve të fundit, qendrueshmëria është kthyer në një faktor kyç për formësimin e zhvillimit të turizmit. Zhvillimi i ri i turizmit në Shqipëri duhet t'u përmbahet praktikave të qëndrueshme... Shqipëria duhet të krijojë një kuadër kombëtar për zhvillimin e qendrueshëm...për të orientuar projektet e mëvonshme zhvillimore dhe për t'i përafuar ato me parimet e qëndrueshmërisë.”

Projekt Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030 (tetor 2024)

“Turizmi i qëndrueshëm” është evidentuar si objektivi kryesor i Projekt Strategjisë Kombëtare për Turizmin, i publikuar për konsultim publik në muajin tetor 2024 ku “turizmi me bazë komunitare”, zhvillimi i produkteve turistike dhe diversifikimi shihen si sfidat kryesore për rritjen e turizmit në Shqipëri. Në këtë dokument do të shpjegohet se çfarë është turizmi i qëndrueshëm, pse është ai i rëndësishëm për Shqipërinë, cilët janë aktorët kryesorë për rritjen e turizmit të qëndrueshëm, pse përfshirja e strukturave lokale dhe e komunitetit është vendimtare, si dhe do të detajohen disa nga qasjet që mund të përdoren për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

SHFRYTËZIMI I PËRVOJËS SË DERITANISHME NË TURIZMIN E QËNDRUESHËM NË SHQIPËRI

Për të realizuar këtë vizion strategjik për sektorin e turizmit të qëndrueshëm, ne duhet të arrijmë në një emërues të përbashkët në lidhje me kuptimin e konceptit Turizëm i Qëndrueshëm dhe duhet të bazohemi në përvojën praktike. Për 7 vite me rradhë, nga viti 2017 deri në vitin 2024, puna e projektit RisiAlbania i financuar nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, ka qenë tejet e përqendruar në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Kjo punë ka përfshirë krijimin e partneritetit me 20 operatorë kombëtarë turistikë dhe Organizata lokale të Menaxhimit të Destinacioneve – DMO (Visit Gjirokastra dhe Visit Saranda) për të diversifikuar shërbimet dhe produktet e tyre, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përvojave autentike të turizmit vendas, hapjes së lokacioneve të reja rurale dhe ekoturizmit. Ky projekt ka testuar qasjet për zhvillimin e produkteve të turizmit të qëndrueshëm, ka eksploruar kërkesën ndërkombëtare nga turistët dhe industria e udhëtimit për këto produkte, ka arritur të kuptojë mënyrën se si duhet të punohet me bizneset lokale, të vogla dhe familjare për të zhvilluar turizmin lokal, dhe ka vlerësuar nivelin e pranueshmërisë nga ana e komuniteteve lokale ndaj këtij lloji turizmi që i përfshinte ata në përvoja autentike në lidhje me kuzhinën, kulturën dhe traditën e tyre. RisiAlbania ka punuar edhe për lidhjen e bizneseve shqiptare të turizmit me standardet dhe certifikimin e Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC).

Pra, ky dokument buron dhe bazohet pikërisht në këtë përvojë të pasur për të ofruar disa ide në lidhje me zhvillimin në të ardhmen të turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri.

*Ky material merr në konsideratë zhvillimet e sektorit deri më dhjetor 2024, periudhë gjatë së cilës strategjia kombëtare ishte në proces konsultimi publik.

ÇFARË ËSHTË TURIZMI I QENDRUESHËM?

Turizmi i qëndrueshëm është një term i njohur globalisht dhe që po përdoret gjithnjë e më shumë për atë lloj turizmi që synon të zvogëlojë ndikimet negative dhe të rrisë përfitimet në 3 fusha kryesore.

1) **Mjedisi:** Mjedisi natyror, fauna e egër, bimët dhe kontributi ndaj faktorëve që lidhen me ngrohjen globale.

2) **Kultura dhe trashëgimia:** Trashëgimia e krijuar, kultura jomateriale (p.sh. muzika, vallet, folklori), identiteti kulturor dhe komuniteti modern.

3) **Ekonomia:** Veçanërisht përfitimet ekonomike lokale – punësimi, jetesa dhe të ardhurat

TURIZMI I QËNDRUESHËM



Mjedisi



*Kultura
& Trashëgimia*



Ekonomia

Turizmi i qëndrueshëm e njeh aftësinë e turizmit për të sjellë dëme, por edhe potencialin e tij për të sjellë ndryshime pozitive, si për shembull, nëpërmjet mbrojtjes së mjediseve dhe trashëgimisë së krijuar, evidentimit të rëndësishëm të kulturës, reduktimit të migrimit të rinjve ose migrimit nga zonat rurale në ato urbane, krijimit të vendeve të punës dhe mbështetjes së mjeteve të jetesës në nivel lokal.

Turizmi i Qëndrueshëm është një qasje ndaj turizmit që po përqafohet gjithnjë e më shumë nga bizneset turistike, destinacionet, si dhe pushteti vendor dhe ai qendror. Ai është përkufizuar nga agjenci ndërkombëtare si Programi i OKB-së për Mjedisin dhe Organizata e OKB-së për Turizmin dhe promovohet dhe mbështetet nëpërmjet organeve të industrisë së turizmit si Këshilli Global i Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC) të cilët kanë përgatitur kritere, sisteme trajnimi dhe certifikimi për turizmin e qëndrueshëm në biznese, destinacione, ngjarje dhe agjenci qeveritare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e turizmit.

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM TURIZMI I QËNDRUESHËM?

Turizmi i qëndrueshëm është i rëndësishëm nga këndvështrimi etik, social/politik dhe nga këndvështrimi i tregut:

Rëndësia etike e turizmit të qëndrueshëm: Sigurisht që turizmi i qëndrueshëm përmban një dimension të rëndësishëm etik. Turizmi i qëndrueshëm është qartazi qasja më etike ndaj zhvillimit të turizmit në një botë që po përballlet me ngrohjen globale dhe ku industria e turizmit po tërheq vëmendje negative sa i takon ndikimit të saj mbi mjedisin, komunitetet dhe kulturën.

Raporti i vitit 2024 ([2024 report](#)) i OECD-së për Tendencat dhe Politikat e Turizmit

“Prioritetet kryesore politike: promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm përmes turizmit: ‘Rimëkëmbja e fortë [pas pandemisë] po shërben si një këmbanë e re alarmi për qeveritë dhe sektorin në tërësi, pasi destinacionet janë duke u sforcuar për të menaxhuar kërkesën dhe ndikimet në mjedis dhe në komunitetet lokale. Kjo situatë është duke ushtruar presion mbi licencën sociale për turizmin dhe ka nxjerrë në pah nevojën për të ribalancuar ndikimet, për të kuptuar kompromiset dhe për të menaxhuar turizmin në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që përfitimet të tejkalojnë kostot. Në të njëjtën kohë, turizmi ofron potencial të pashfrytëzuar për shumë njerëz, biznese dhe vende.’


Rëndësia sociale dhe politike e turizmit të qëndrueshëm: Turizmi i qëndrueshëm është i rëndësishëm edhe nga këndvështrimi social, dhe për rrjedhojë për qeverisjen. Në shumë vende, rritja e turizmit ka krijuar xhepa me mbiturizëm duke provokuar kështu zemërim dhe indinjatë në rradhët e komuniteteve lokale, të cilët mendojnë se turizmi është një aktivitet që po iu imponohet, nga i cili përfitojnë kryesisht investitorët e jashtëm, dhe që ofron përfitime të pakta në aspektin e vendeve të punës dhe punësimit dhe sjell ndikime negative në kulturën dhe komunitetin vendas. Turizmi i qëndrueshëm ka potencialin për të krijuar një turizëm të bazuar më shumë në angazhimin dhe pjesëmarrjen popullore në bazë dhe për të shmangur humbjen e identitetit kulturor, i cili në fakt është një nga pikat kryesore të forta të Shqipërisë në tregun evropian të turizmit.

Rëndësia e tregut të turizmit të qëndrueshëm: Turizmi i qëndrueshëm është edhe një mundësi e madhe tregu si dhe një mundësi nga e cila mund të përfitojnë destinacionet e reja turistike (si për shembull Shqipëria). Ndërgjegjësimi dhe kërkesa për "turizëm më të përgjegjshëm" si dhe kërkesa për destinacione që ofrojnë përvoja autentike është rritur qartazi. Për shembull, sipas një ankete të zhvilluar në platformën Booking.com në vitin 2024 ([Booking.com survey in 2024](#)), "75% e udhëtarëve në mbarë botën shprehen se dëshirojnë të udhëtojnë në mënyrë më të qëndrueshme gjatë 12 muajve të ardhshëm dhe (43%) shprehen se do të ndiheshin fajtorë nëse do të bënin zgjedhje më pak të qëndrueshme për udhëtimet e tyre". Kërkesa ekzistuese për produktet e turizmit të qëndrueshëm është e konsiderueshme dhe vjen në rritje. Një anketim i vitit 2024 me anëtarët e Shoqatës Ndërkombëtare të Tregtisë së Udhëtimeve të Aventurës (ATTA) e ka renditur qëndrueshmërinë si çështjen prioritare së bashku me mbiturizmin. Anëtarët e kësaj Shoqate janë të ndërgjegjshëm për kërkesën e madhe që ekziston për turizmin e qëndrueshëm dhe interesin për të identifikuar destinacionet me një numër më të ulët turistësh (përtej shtigjeve të rrahura). Nevoja për autenticitet dhe qëndrueshmëri është një element i përsëritur në tendencat kryesore të turizmit, i identifikuar edhe nga analiza e industrisë turistike gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Turizmi i qëndrueshëm ka një dividend të mundshëm çmimi: Turizmi vërtet i qëndrueshëm, si ekoturizmi dhe turizmi kulturor dhe përvojat që mund të shihen si përvoja që i shërbejnë drejtpërdrejt komuniteteve lokale, mund të komercializohen me çmime më të larta në krahasim me turizmin tradicional. Kjo është diçka e rëndësishme për tregun shqiptar të turizmit, i cili është bërë i njohur si një "destinacion evropian ekonomik" dhe rritja e vlerës dhe e unicitetit të tregut turistik të Shqipërisë është një prioritet kyç për vendin.

CILAT TENDENCA JANË NË FOKUS PËR JU NË VITIN 2024?

Zgjidhni cilat tendenca prisni të ndikojnë më shumë në udhëtimet/turizmin e aventurës:



Sondazhi i Komunitetit ATTA, janar 2024 (n=80) Grafik: Shoqata e Tregtisë së Udhëtimit Adventur.

KUSH MUND TË NDIKOJË NË RITJEN DHE ZHVILLIMIN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM NË SHQIPËRI?

Turizmi i qëndrueshëm duhet të zhvillohet në nivel edhe më të gjerë duke përfshirë edhe pushtetin vendor dhe qendror – ku mbështetja, angazhimi aktiv dhe ndryshimi prek të gjithë sektorin. Turizmi i qëndrueshëm nuk mund të zhvillohet me qasje të forta nga lart-poshtë (përmes politikave, rregulloreve apo edhe financimit) dhe as nuk mund të zhvillohet thjesht në nivel lokal apo në nivel sektorial. Turizmi i qëndrueshëm kërkon zhvillim dhe promovim të integruar nga baza (komunitetet), përmes aktorëve lokalë dhe kombëtarë e deri tek aktorët kryesorë ndërkombëtarë dhe partnerët ekzistues dhe potencialë ndërkombëtarë.

Komuniteti ndërkombëtar dhe kombëtar



Niveli lokal dhe komuniteti



Veprimi i koordinuar për turizmin e qëndrueshëm

- **Në nivel ndërkombëtar:** Për të qenë sa më efikas, turizmi i qëndrueshëm në Shqipëri duhet të për afrohet me standardet dhe qasjet ndërkombëtare dhe bizneset turistike shqiptare duhet të lidhen në mënyrë efektive me industrinë ndërkombëtare të turizmit, gjë që mund t'i tërheqë turistët për të zgjedhur dhe preferuar përvojat e turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri.
- **Qeveria Shqiptare (në nivel qendror):** Turizmi i qëndrueshëm është konsideruar si një prioritet në strategjitë dhe politikat kombëtare dhe në promovimin e Shqipërisë si destinacion dhe markë. Stimujt dhe mbështetja synojnë rritjen e turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri.
- **Pushteti vendor:** Turizmi i qëndrueshëm është pjesë e planeve të zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal dhe mbështetet në mënyrë strategjike dhe praktike.
- **Bizneset dhe investitorët më të mëdhenj të turizmit:** Përqafojnë standardet e qëndrueshme në bizneset e tyre, por edhe bashkëpunojnë me NMV-të, komunitetet dhe organizatat jofitimprurëse lokale për të diversifikuar shërbimet dhe për të 'lokalizuar' zinxhirët e tyre të furnizimit.
- **Ndërmarrjet mikro dhe të vogla (NMV):** Janë në qendër të turizmit të qëndrueshëm, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe produkteve që do ta bëjnë ofertën turistike shqiptare të larmishme, të dallueshme dhe autentike. Organizatat jofitimprurëse dhe komunitare: Organizatat ekzistuese dhe të reja me bazë komunitare dhe jofitimprurëse (përfshirë DMO-të e iniciuara në nivel lokal) përqafojnë turizmin e qëndrueshëm si një metodë ruajtjeje, mbrojtjeje dhe fuqizimi të komunitetit.
- **Komunitetet lokale:** Kanë zë dhe ndikim efikas në rritjen e turizmit dhe përfshihen në ofrimin e shërbimeve dhe të përvojave autentike turistike në mënyrë fitimprurëse për ato komunitete.

PËRFSHIRJA E QEVERISË DHE KOMUNITETIT NË RRRITJEN E TURIZMIT TË QËNDRUESHËM NË SHQIPËRI

Sektori privat është vendimtar për zhvillimin dhe rritjen e turizmit të qëndrueshëm, ku Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla në nivel lokal janë të një rëndësie të veçantë; por qeveria dhe komunitetet janë të domosdoshme për rritjen e turizmit të qëndrueshëm.



Mbështetja e Pushtetit Qendror për Turizmin e Qëndrueshëm

Siç theksohet në Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2024-2025, Qeveria Shqiptare (QSH) luan rol vendimtar në përcaktimin e përparësive, mbështetjen dhe nxitjen e turizmit të qëndrueshëm. Kjo përfshin jo vetëm integrimin e turizmit të qëndrueshëm në aktivitetet e Agjencive Qeveritare si Agjencia Kombëtare e Turizmit në Shqipëri dhe DMO-të ekzistuese dhe ato në zhvillim e sipër (Organizatat e Menaxhimit të Destinacioneve), por edhe koordinimin më të gjerë me departamentet dhe agjencitë e përfshira në punën për zhvillimin mjedisor, kulturor, ekonomik dhe në promovimin e biznesit të vogël.



Mbështetja e Pushtetit Vendor për Turizmin e Qëndrueshëm

Pushteti vendor luan rol vendimtar sa i takon garantimit të rritjes së turizmit në mënyra sa më të qëndrueshme, nëpërmjet investimeve lokale, zhvillimit të infrastrukturës dhe rregullave të planifikimit. Planifikimi dhe rritja joefektive e turizmit masiv mund të ndikojë në rritjen e mundshme aktuale dhe të ardhshme të turizmit të qëndrueshëm dhe, për këtë arsye, duhet të planifikohet në mënyrë sa më efektive.



Përfshirja e komunitetit në turizmin e qëndrueshëm

Ndërkohë që koncepti i përfshirjes së komunitetit në turizmin e qëndrueshëm tingëllon mirë në teori, shpesh është e vështirë që ai të integrohet në mënyrë domethënëse në planifikimin e zhvillimit të turizmit dhe në operacionet turistike. Përfaqësimi efikas i komunitetit ndoshta do të kërkonte formimin e grupeve të interesit dhe përfaqësuese të shoqërisë civile në nivel lokal aty ku ekziston, rritet apo planifikohet aktiviteti turistik.

PRODUKTET DHE SHËRBIMET E QËNDRUESHME TURISTIKE

Turizmi i qëndrueshëm kërkon jo vetëm përshtatjen dhe respektimin e standardeve të qëndrueshmërisë, por edhe inovacion dhe sipërmarrje për të zhvilluar dhe zgjeruar shërbimet, produktet dhe përvojat turistike. Turizmi i qëndrueshëm nuk është një aktivitet normal me aspektin e shtuar të aplikimit të praktikave të qëndrueshme, por përfshin produkte dhe shërbime inovative që janë të përshtatura për mundësitë dhe mjediset lokale, dhe për këtë arsye, unike. Për shembull:

Turizmi i Qëndrueshëm Emergjent në Zhvillim

Ndërkohë që turizmi i qëndrueshëm është ende një sektor i ri, janë të shumtë shembujt e evidentuar të produkteve dhe të destinacioneve ku ekoturizmi, përvojat autentike dhe produktet nga të cilat përfitojnë me të vërtetë komunitetet lokale në Shqipëri kanë rezultuar tejet të suksesshme dhe interesante. Për shembull:

- **Ekoturi i faunës së egër, kulturës lokale dhe gastronomisë në Shqipërinë e Jugut**, i zhvilluar nga Operatori Turistik Shqiptar, Albanian Trip dhe i promovuar nëpërmjet operatorëve ndërkombëtarë të udhëtimit, duke përfshirë Intrepid Travel me seli në Mbretërinë e Bashkuar dhe i promovuar si përvojë unike në një artikull të një gazete të rëndësishme në Mbretërinë e Bashkuar ([article in a major UK newspaper](#)).
 - **Kasollet e barinjve të transformuara në struktura akomoduese turistike**. Një bashkëpunim midis një kompanie vendase udhëtimi dhe një operatori ofrues të udhëtimeve me kuaj ([Caravan Horse Riding Albania/C-Adventures and Tours](#)) që çoi në krijimin e mundësisë së akomodimit në kasollet e barinjve ([shepherd hut accommodations](#)), gjë e cila ka zgjeruar shtigjet turistike duke diversifikuar në të njëjtën kohë të ardhurat për barinjtë në kodrat e Shqipërisë së Jugut.
 - **Turizmi Ornitologjik, identifikimi dhe hapja e zonave për vëzhgimin e shpendëve në Shqipëri**. Shqipëria është bërë e njohur për turizmin e fokusuar tek vëzhgimi i shpendëve. Ky vend jo vetëm që po tërheq specialistë ndërkombëtarë të turizmit të shpendëve (p.sh. [The Travelling Naturalist](#)), por është duke rritur edhe numrin e agjencive të specializuara turistike kombëtare si për shembull [Birding Albania](#). Ky ndërgjegjësim gjithnjë e më i madh në lidhje me pozicionin e Shqipërisë në udhëtimet ornitologjike ka filluar të mbështesë përpjekjet konservuese rreth ligatinave të brishta dhe habitateve të tjera të faunës së egër si laguna Vjosë-Nartës.
- **Zgjerimi i produkteve dhe përvojave të ekoturizmit**: Zgjerimi dhe përshtatja e produkteve dhe përvojave turistike me qëllim përfshirjen e faunës së egër, të habitateve natyrore (p.sh. malet, detet dhe ligatinat) dhe lidhja e qartë e saj me nismat për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.
 - **Turizmi i ngadaltë**: "Turizmi i ngadaltë" është një koncept që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi dhe që përqendrohet në udhëtimin më të ngadaltë (p.sh. me rrugë tokësore), qëndrimin për një periudhë më të gjatë në vende specifike, eksplorimin më të thellë dhe prioritizimin e shërbimeve dhe produkteve lokale.

- **Përvojat turistike autentike dhe gjithëpërfshirëse:** Autenticiteti në turizëm njihet si një nga kërkesat kryesore të turistëve dhe të industrisë turistike ndërkombëtare. Këto përvoja përfshijnë vizitat në vende autentike (fshatra, qyteza dhe qytete), përjetimin e kulturës autentike dhe të gjallë dhe të mikpritjes lokale, shijimin e prodhimit, kuzhinës dhe produkteve dhe shërbimeve lokale, deri edhe pjesëmarrjen në festivale autentike, aktivitete artizanale ose ngjarje kulturore.



AFSA, një operator turistik lokal, prezanton dhe promovon Ushqimin e Ngadaltë përmes një kursi kuzhine në zonën e Lunxhërisë, qarku Gjirokastrë, mbështetur nga Helvetas.

- **Ushqimi i Ngadaltë dhe 'ferma në tryezë':** Për gati tre dekada, ushqimi i ngadaltë (slow food) është kthyer në një lëvizje të përqendruar në prioritizimin e recetave dhe metodave tradicionale, përbërësve organikë dhe lokalë, në ushqimin tejet cilësor të gatuar ngadalë dhe më pas të shijuar dhe konsumuar po në mënyrë të ngadaltë. Shqipëria e ka përqafuar këtë lëvizje e cila po vjen gjithnjë e më shumë duke u rritur, dhe një shembull që vlen të përmendet këtu është Fondacioni 'Ushqimi i Ngadaltë për Diversitetin' (Slow Food Foundation for Diversity) në rajonin e Përmetit në Shqipëri i mbështetur nga CESVI. Kjo është shoqëruar edhe me lëvizjen 'ferma në tryezë' ('farm to table'), ku restorantet, hotelet dhe resortet vendosin lidhjet e tyre me prodhuesit dhe fermerët vendas për të përmirësuar cilësinë e prodhimit, për të garantuar përfitime ekonomike lokale dhe mundësisht për të ofruar përvojë unike për klientët që mund të vizitojnë fermat ku janë rritur ose prodhuar përbërësit apo produktet.
- **Zinxhirët e furnizimit gjithëpërfshirës në turizëm:** Për sa kohë që sektori i turizmit është blerësi kryesor i input-eve (siç janë produktet dhe ushqimet), i shërbimeve të jashtme (p.sh. guidat, transporti, shërbimet e qiradhënies, përvojat për mysafirët) dhe i produkteve (p.sh. artizanati, mobiljet, arti), ekziston mundësia për të forcuar dhe lokalizuar zinxhirët e furnizimit për ta bërë përvojën turistike më unike dhe autentike dhe për të maksimizuar përfitimet lokale në ekonomi dhe punësim.

RisiAlbania i ka testuar të gjitha këto qasje përmes punës së saj me Visit Gjirokastra (DMO) dhe me operatorët turistikë shqiptarë dhe ka dëshmuar kërkesën e madhe në tregjet ndërkombëtare për to, tërheqjen shumë të fortë të konsumatorëve dhe nivelin e lartë të kënaqësisë nga ana e konsumatorëve. Turizmi i qëndrueshëm jo vetëm që funksionon për turistët dhe bizneset turistike, por hap edhe mundësi për ta bërë turizmin ekonomikisht më gjithëpërfshirës për bizneset, fermerët, prodhuesit, komunitetet dhe familjet vendase.

**Rast studimor: Rikthimi në Jetë i Shtëpive Historike
përmes Turizmit të Qëndrueshëm dhe Komunitar (Case
study: Bringing Back Life to Historic Houses through
Sustainable and Community Tourism
(<https://www.krujaalbergodiffuso.com>))**

Në Krujë, turizmi është përballur me sfida të shumta në zonën historike të Kalasë së Krujës. Kjo zonë ishte kryesisht e braktisur, gjë që çoi në nxjerrjen e shtëpive në shitje nga pronarët e tyre me çmim tejet të reduktuar (nga 40,000 € - 50,000 €) dhe në zhvlerësimin e zonës historike si një zonë e mundshme turistike. Zona është përballur me neglizhencë të madhe, me mbetje dhe ndotje të konsiderueshme, të cilat iu bashkuan vështirësive ekonomike me të cilat përballëshin shumë familje vendase.



Ky skenar u transformua në mënyrë rrënjësore nga një nismë për zhvillimin e turizmit, e quajtur projekti Albergo Diffuso. Me shuma të vogla financiare, shtëpitë historike dhe të braktisura u rinovuan me kujdes dhe u vendosën nën një strukturë të re të menaxhimit të turizmit, duke krijuar kështu një destinacion unik dhe tërheqës. Në vitet e para si projekt pilot, Albergo Diffuso Kruja, i mbështetur nga projekti RisiAlbania, tërhoqi me sukses rreth 1,000 vizitorë, me afërsisht 1,000 netë fjetje të regjistruara. Kjo nismë rriti ndjeshëm interesin për pronat lokale, duke trefishuar vlerën e tyre dhe duke motivuar pronarët përkatës për të investuar më tej për shndërrimin e shtëpive të tyre në struktura akomoduese turistike.

Rrjedhimisht, të ardhurat e familjeve u përmirësuan dukshëm, duke u rritur nga afërsisht 100 Euro në muaj në 80 Euro/nata vetëm nga dhënia me qira e dhomave. Të frymëzuar nga numri në rritje i vizitorëve, aktorët lokalë bashkëpunuan në mënyrë më efektive për të ofruar produkte autentike lokale turistike dhe përvoja kulturore. Ky model i suksesshëm është vlerësuar edhe në nivel ndërkombëtar kur National Geographic e rekomandoi Albergo Diffuso Kruja si një vend që duhet vizituar, duke evidentuar potencialin dhe rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm me bazë komuniteti. Përveç kësaj, ky model ka shërbyer si frymëzim jo vetëm për lagjen e Kalasë së Krujës por edhe për të gjithë qytetin e Krujës, duke çuar në një rritje të ndjeshme të ambienteve akomoduese në të gjithë qytetin duke filluar nga viti 2024.

FUQIA DHE RËNDËSIA E ANGAZHIMIT DHE PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT

Përmbushja e vizionit për një sektor të turizmit të qëndrueshëm në rritje dhe diversifikim të vazhdueshëm në Shqipëri kërkon angazhimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve lokale. Rritja e paqëllimtë e turizmit mund të çojë në marginalizimin e mëtejshëm të komuniteteve dhe bizneseve lokale, pasi pjesa më e madhe e përfitimit do të shkojë te bizneset më të mëdha turistike dhe investorët. Siç është dëshmuar edhe në shumë vende turistike në të gjithë Evropën dhe në mbarë botën, kjo mund të çojë në rritjen e negativitetit lokal ndaj turizmit.

Siç ilustron nga shumë prej shembujve të produkteve të turizmit të qëndrueshëm më sipër, zhbllokimi i rritjes së turizmit vërtet të qëndrueshëm duhet të përfshijë komunitetet lokale, bizneset dhe familjet. Kjo mundësi u vlerësua dhe u shfrytëzua nga Kerala, shtet në Indinë Jugperëndimore, i cili arriti të transformonte turizmin në vendin e tyre nga një turizëm që përballej me pakënaqësi në rritje nga ana e komuniteteve në një turizëm me një markë të fuqishme dhe unike. Kerala përdori sistemin e qeverisjes së komunitetit indigjen për të angazhuar komunitetet lokale në turizëm. Në Shqipëri kjo mund të arrihet duke zbatuar në mënyrë efikase qasjen e Programit LEADER të Bashkimit Evropian (European Union's LEADER Programme) për zhvillimin lokal dhe rural me pjesëmarrje të gjerë dhe të udhëhequr nga komuniteti.

Nxitja e Inovacionit Lokal në Turizmin e Qëndrueshëm përmes Operatorëve Turistik Shqiptarë

RisiAlbania i ka hapur rrugën qasjes së punës përmes 'operatorëve turistikë inovativë për të ofruar mbështetje për komunitetet dhe bizneset lokale, me qëllim zhvillimin e strukturave akomoduese unike dhe autentike, të shtigjeve të reja për ekoturizëm (marshimi në natyrë, vëzhgimi i shpendëve, shëtitjet me kalë) dhe të përvojave autentike kulturore. Operatorët turistikë i kishin kuptuar kriteret e cilësisë që duhet të përmbushnin për t'u bërë pjesë e tregjeve ndërkombëtare të turizmit dhe kishin krijuar lidhjet e tyre me këtë treg. Komunitetet lokale, familjet dhe bizneset zotëronin tokën dhe me qasjen tek financat dhe njohuritë praktike, ata mund të rrisnin bizneset ekzistuese dhe të reja për t'u përshtatur me llojet e reja të turizmit (shih rastin studimor të projektit RisiAlbania : Inovacioni për Punësimin në Sektorin e Turizmit në Shqipëri (Innovation for Employment in Albania's Tourism Sector).



RËNDËSIA E NDËRMARRJEVE MIKRO DHE TË VOGLA (NMV) NË TURIZMIN E QËNDRUESHËM

Ashtu si komunitetet lokale, edhe NMV-të janë tejet të rëndësishme për turizmin e qëndrueshëm. Realizimi i turizmit të ngadaltë, ushqimit të ngadaltë, të përvojave autentike dhe zinxhirëve të furnizimit lokal duhet të shoqërohet me mbështetjen dhe zhblokimin e mundësive për rritje dhe inovacion të NMV-ve. Turizmi i qëndrueshëm nuk do të arrihet vetëm nga investitorët më të mëdhenj dhe bizneset turistike – por do të zgjerohet më tej me anën e bashkëpunimit efikas me bizneset më të vogla dhe ato mikro, me grupet e prodhuesve dhe me sektorin më informal (për shembull familjet ose grupet kulturore që presin turistë për t'u bërë pjesë e përvojave të ndryshme).

Prandaj, NMV-të janë pjesë përbërëse e punës për zgjerimin e mëtejshëm të turizmit të qëndrueshëm dhe çdo mbështetje ose gjetje duhet t'i përfshijë ato, duke filluar nga NMV-të më lokale, mikro dhe ndoshta më pak formale (p.sh. familjet pritëse, grupet kulturore, familjet, guidat lokale, fermerët) deri tek ato më të konsoliduara dhe formale (p.sh. operatorët turistikë, restorantet, bujtinat, hotelet e zonës, ofruesit e transportit).



ROLI I CERTIFIKIMIT DHE STANDARDEVE NË TURIZMIN E QËNDRUESHËM

Standardet dhe certifikimi në turizmin e qëndrueshëm kanë fituar më shumë popullaritet dhe rëndësi. Standardet ndërkombëtare, si për shembull standardet e Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm (GSTC) (Global Sustainable Tourism Council (GSTC)), janë duke u adoptuar gjithnjë e më shumë në nivel ndërkombëtar, kombëtar, rajonal dhe në nivel ndërmarrjeje. Pavarësisht kërkesës në rritje të konsumatorëve për më shumë produkte të 'turizmit të përgjegjshëm', niveli i njohjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve në lidhje me standardet e turizmit të qëndrueshëm është i ulët dhe nuk ndihmohet nga përhapja e dukshme e organeve dhe emrave të certifikimit. Pavarësisht njohjes së pakët nga ana e konsumatorëve, standardet dhe certifikimi luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e besimit të konsumatorëve dhe rritjen e turizmit të qëndrueshëm.

- **Standardet dhe certifikimi si një mënyrë për të rritur besimin e konsumatorit për turizmin e qëndrueshëm:** Perceptimet në lidhje me "larjen e gjelbër" dhe "larjen etike" të produkteve turistike kanë minuar edhe punën legjitime të realizuar për turizmin e qëndrueshëm. Standardet dhe certifikimi janë një mënyrë për të rikthyer dhe forcuar besimin e konsumatorëve.
- **Rritja e tregut për turizmin e qëndrueshëm përmes zinxhirit të furnizimit të turizmit:** Edhe Operatorët Ndërkombëtarë Turistikë janë gjithnjë e më shumë në kërkim të partnerëve të certifikuar në fushën e turizmit të qëndrueshëm, për t'i ndihmuar në rritjen e kësaj pjese të tregut.
- **Nxitës dhe stimul për ndryshimin e praktikave në turizmin e qëndrueshëm:** Certifikimi mund të shërbejë në mënyrë efikase si faktor nxitës i rritjes dhe ndryshimit në turizmin e qëndrueshëm.
- **Rregulloret e BE-së për certifikimin:** Rregulloret e BE-së që synojnë të reduktojnë deklaratat çorientuese mjedisore do të hyjnë në fuqi në vitin 2027. 'Direktiva e BE-së për deklaratat e gjelbërta' ('EU green claims directive') mund të udhëheqë koordinimin e punës në lidhje me standardet dhe certifikimin.

Prandaj nga këndvështrimi i Shqipërisë, standardet dhe certifikimi i turizmit të qëndrueshëm po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Është e rëndësishme që qasja e përdorur nga Shqipëria ndaj certifikimit të jetë e integruar plotësisht me Standardet Globale – duke rritur integrimin me këtë fushë në evoluim të shpejtë dhe duke shmangur fragmentimin dhe standardet paralele. Qasja e ofruar nga standardet dhe certifikimi shërben jo vetëm për të koordinuar aktivitetin në turizmin e qëndrueshëm, por edhe për t'u dhënë turistëve dhe industrisë ndërkombëtare të turizmit një mesazh të fortë se Shqipëria është në vijën e parë të lëvizjes së vazhdueshme drejt turizmit më të mirë.



PËRMBLEDHJE E MËSIMEVE KRYESORE NË LIDHJE ME TURIZMIN E QËNDRUESHËM

Ky dokument synon të evidentojë disa pika kyçe për rritjen sa më efektive të turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri:

1

Turizmi i Qëndrueshëm nuk është thjesht një zgjedhje etike për rritjen e turizmit, por ofron edhe një mundësi të madhe tregu për Shqipërinë për të zhvilluar **pozicionin e saj të fortë dhe të dallueshëm në turizmin global.**

2

Si një destinacion turistik në zhvillim dhe më pak i njohur, dhe me kultura dhe burime natyrore të pasura dhe të dallueshme, **Shqipëria ndodhet në një pozicion veçanërisht të fortë për të ndërtuar markën dhe reputacionin e saj për turizmin e qëndrueshëm.**

3

Për të realizuar këtë, **përfshirja e komunitetit dhe integrimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla** në zhvillimin e turizmit është i domosdoshëm.

4

Gjithashtu, qasja e fortë nga lart-poshtë nuk do të funksionojë në mënyrë efektive dhe qasjet ndaj **pjesëmarrjes së komunitetit** dhe zhvillimit të **ndërmarrjeve mikro dhe të vogla** duhet të integrohen siç duhet në strategjinë për turizmin e qëndrueshëm.

5

Shqipëria mund të ndërtojë markën dhe reputacionin e saj në Turizmin e Qëndrueshëm si dhe të ndikojë në industrinë kombëtare duke **adoptuar standardet përkatëse ndërkombëtare dhe certifikimin në turizmin e qëndrueshëm.**



Rr. Ismail Qemali,
P18, H.3, Apt. 15
Tiranë, Shqipëri.



+355 (0) 422 48 527



info@risialbania.al